



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.12.2018)

Drejton mbledhjen në cilësinë e anëtarit jo gjyqtar më të vjetër në moshë, zonja Fatmira Luli dhe pas zgjedhjes së Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhja drejtohet nga zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ish sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 10:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Medi Bici* (anëtar)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
4. *Luljeta Laze, Drejtoreshë e ZABGJ-së.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
7. *Artan Spahiu, Kryetar Komisioni i Pavarur i Monitorimit.*
8. *Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.*
9. *Xhezair Zaganjori, Kryetar i Gjykatës së Lartë.*
10. *Dennis Eesner, përfaqësues USAID.*
11. *Anne Trice, Drejtuese e Projektit të USAID Drejtësi për të gjithë.*
12. *Agnes Bernhard, Drejtuese e Misionit EURALIUS V.*
13. *Përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Shqipëri.*
14. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Mbi deklarimin e datës së krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të KLGj-së.
3. Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KLGj-së.
4. Mbi caktimin me short të dy anëtarëve gjyqtarë dhe 2 anëtarëve jo gjyqtarë, për të shërbyer për një mandat 3-vjeçar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Fatmira Luli: Atëherë, ju uroj të tërëve mirëseardhjen në këtë ngjarje të rëndësishme të konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe po ju prezantoj axhendën e mbledhjes së parë të konstituimit të qeverisë së gjyqësorit.

Do të fillojmë me fjalën hapëse të drejtuesit më të vjetër, anëtarit jo gjyqtar të zgjedhur nga Parlamenti, të këtij Këshilli; më pas me miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; zgjedhjen më pas të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; vendimin mbi deklarimin e datës së krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për konstituimin e këtij institucioni dhe; pika e fundit është shorti për dy anëtarët gjyqtarë dhe dy anëtarët jo gjyqtarë, sipas ligjit dhe dispozitave tranzitore të ligjit 115/2016.

Unë jam anëtarja më e vjetër, quhem Fatmira Luli. Ligji, në bazë të nenit 277, më ka vënë përgjegjësinë dhe detyrën për të çelur dhe drejtuar mbledhjen e parë të konstituimit të këtij institucioni të rëndësishëm të qeverisjes së gjyqësorit.

Të nderuar zotërinj pjesëmarrës,

Ambasadorë të Shteteve të Bashkuara, të Komisionit Evropian,

I nderuar zoti Zaganjori, Kryetar i Gjykatës së Lartë, zonja Ballanca, Avokate e Popullit,

Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës,

Të nderuar përfaqësues të mediave.

Jam e nderuar dhe e privilegjuar që në cilësinë e anëtarit më të vjetër jo magjistrat, bazuar në nenin 277 të ligjit 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të hap dhe të drejtoj këtë seancë të parë të mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për konstituimin e këtij organi kolegjal të qeverisjes së gjyqësorit, që do t’i japë jetë ideve dhe synimeve për ta përmirësuar rrënjësisht sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Data e sotme do të hyjë në histori si data e vendosjes së një guri të rëndë në themelet e godinës së re të sistemit të drejtësisë shqiptare, themele të cilat janë çimentuar 2 vjet më parë me ndryshimet e thella kushtetuese dhe ligjore, si shprehje e vullnetit të ligjbërësve shqiptarë dhe e mbështetjes së qëndrueshme dhe pa kushte të partnerëve ndërkombëtarë, disa përfaqësues të të cilëve të pranishëm në këtë ceremoni, për të cilën përfitoj nga rasti t’i falenderoj për angazhimet dhe kontributin e vyer të tyre edhe në emër të kolegëve anëtarë të këtij Këshilli.

Ky hap që po hedhim sot, për mua dhe për secilin nga kolegët anëtarë të këtij Këshilli, është një sfidë dhe fillimi i një epoke të re ndryshimi në sistemin e qeverisjes së pushtetit gjyqësor, me synimin për të përmbushur misionin që sistemi gjyqësor të jetë i pavarur nga çdo lloj ndikimi, i paanshëm në funksionin e tij, i përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral e profesional në të gjithë nivelet gjyqësore e strukturore të tij, eficient, i besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm nga publiku dhe bashkëpunues në nivelin institucional në të gjithë anëtarët e këtij Këshilli, në çdo vendimmarrje, për emërimin e gjyqtarëve dhe funksionarëve të të gjitha niveleve në sistemin gjyqësor, si dhe për të parandaluar dhe ndëshkuar çdo mbartës së fenomeneve negative ose dëmtuese që vijnë në fokusin e reformës së thellë në sistemin gjyqësor.

Ky hap që po hedhim sot, i hap rrugë zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve dhe drejtuesve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ashtu edhe zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë për vënien në funksionim të këtyre institucioneve të rëndësishme kushtetuese të pushtetit gjyqësor.

Ky hap që po hedhim sot, gjithashtu është i rëndësishëm sepse konstituimi dhe fillimi i funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor konfirmon progresin në forcimin e pavarësisë së institucionit të drejtësisë si një ndër prioritetet që Shqipëria po përmbush për të marrë statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian.

Përmbushja e funksioneve që Kushtetuta në nenet 147, 147/a e vijues dhe ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i jep Këshillit të Lartë Gjyqësor, na obligojnë secilin nga anëtarët e këtij Këshilli për të ndërmarrë që sot e në vijim vendime të rëndësishme sipas prioriteteve, si për organizimin dhe funksionimin e Këshillit edhe bashkëpunimin institucional me Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin, duke siguruar dhe garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë, transparencën, eficientë dhe për të nxjerrë nga agonia dhe rivitalizuar sistemin gjyqësor, duke siguruar dhe garantuar pavarësinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, si dhe statusin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

Në këtë këndvështrim, identifikimi i problematikave dhe masave apo detyrave emergjente që duhet të përmbushi Këshilli, mbeten për t'u analizuar, vlerësuar dhe vendosur në mbledhjet e ardhshme të komisioneve përkatëse ose në mbledhjet plenare të këtij Këshilli.

Pa dashur të zgjatem në këtë fjalë hapje si anëtarja më e vjetër dëshiroj të përcjell një mesazh në formë betimi për secilin anëtar të këtij Këshilli se, është koha dhe shansi historik i secilit prej nesh dhe të gjithëve së bashku për të punuar me profesionalizëm, përkushtim, përgjegjshmëri, paanshmëri dhe frymë bashkëpunimi, për të ndryshuar rrënjësisht sistemin e drejtësisë që po lëmë pas dhe për t'i dhënë shqiptarëve një sistem drejtësie, pushtet gjyqësor të pavarur, profesional dhe efektiv, që ato e meritojnë, si një prej pushteteve funksionale të shtetit të së drejtës, që garanton mbikëqyrjen, interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Ju faleminderit!

Sipas axhendës së miratuar paraprakisht me të tërë anëtarët, me të cilët kemi qenë në konsultim gjatë gjithë punës përgatitore, kemi përgatitur një rregullore për votimin e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, me të cilën jeni njohur dhe e keni përpara secili prej jush.

Jeni dakord me rregulloren që kemi në tavolinë për zgjedhjet?

Votojmë me dorë!

Dakord?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord!

Atëherë, të procedojmë me votimin.

Administrata të bëjë gati fletët e votimit për të proceduar me rregulloren.

Emrat, kandidatët për të cilët do të konkurrojnë janë: për Kryetar – 1. Naureda Llagami, 2. Fatmira Luli, 3. Alban Toro; për Zëvendëskryetar – 1. Alban Toro, 2. Fatmira Luli, 3. Maksim Qoku. Këto janë të tre kandidatët për Kryetar, Fatmira, Albani dhe Naureda.

Atëherë, urdhëroni!

Procedoni me fletët e votimit.

Për të qartësuar edhe pjesëmarrësit, procedura e votimit është e hapur. Është rënë dakord që të votohet dhe fletë votimi, por me një procedurë të hapur. Të tëra rezultatet dhe emrat e anëtarëve që kanë votuar do të lexohen këtu në sallë përpara medias dhe të pranishmëve të ftuar. Leximi i materialit do të bëhet nga administrata, edhe i rezultateve të votimit.

(Pas përgatitjes së fletëve të votimit dhe pas votimit nga të gjithë anëtarët e Këshillit, nga administrata mbledhen fletët dhe rezultati është si më poshtë.)

Xhevdet Haxhiu: Në përfundim të votimit për Kryetarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, po lexojmë votat e gjithsecilit.

Zonja Brunilda Kadi ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zoti Medi Bici ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zonja Fatmira Luli ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zoti Maksim Qoku ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zonja Brikena Ukperaj ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zoti Dritan Hallunaj ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zonja Naureda Llagami ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zoti Alban Toro ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zonja Marçela Shehu ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Zoti Erjon Muharremaj ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Dhe zoti Ilir Toska ka votuar për zonjën Naureda Llagami.

Pra, siç shihet, dhjetë (10) vota ka marrë kandidatja zonja Naureda Llagami, një (1) votë kandidatja Fatmira Luli dhe asnjë votë kandidati Alban Toro.

(Merr drejtimin e mbledhjes zonja Naureda Llagami, si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.)

Naureda Llagami: Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Kryetar i Gjykatës së Lartë, Profesor Zaganjori,

E nderuar Avokate e Popullit, zonja Ballanca,

Të nderuar drejtues të misionëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Ju drejtohem prapë ju të nderuar kolegë,

Ju falenderoj përulësisht për besimin që më dhatë sot duke më votuar si Kryetare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me inkurajimin tuaj që në momentin e parë kur kam vendosur të kandidojë për këtë funksion, jam udhëhequr nga i vetmi parim konsensusi dhe uniteti i kësaj trupe. Me besimin tuaj unë sot u zgjodha Kryetare e këtij Këshilli, por ajo që më gëzon më shumë mbi të gjitha është konsensusi dhe besimi që ne treguam karshi njëri-tjetrit, elementë këto për të cilët unë do të kujdesem që të na shoqërojnë gjatë gjithë veprimtarisë sonë në këtë Këshill. Nga sot, ne nisim së bashku një rrugë me shumë përgjegjësi drejt konsolidimit të një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, të pakorruptuar dhe të pandikuar nga politika.

Suksesi i kësaj rruge kërkon angazhimin tonë profesional, si një trupë kompakte, me një ndjenjë të lartë përgjegjshmërie. Ndjem e nderuar që do punojë me një skuadër profesionistësh me integritet dhe një ekspertizë dinamike dhe besoj fort se këto cilësi janë premisa thelbësore për të realizuar pritshmëritë që ka publiku ndaj këtij institucioni.

Dhe sa i takon në mënyrë të veçantë, rikthimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit, që ndërsa është një nga objektivat dhe detyrat primare tona është edhe sfida më e madhe që kemi. Aksesit i publikut në drejtësi është një prej elementeve më të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, që i jep kuptim edhe shprehjes që drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket e tillë në sytë e publikut.

Ky Këshill ka për detyrë të hartojë, miratojë dhe zbatojë vendime të cilat jo vetëm të forcojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e sistemit gjyqësor, por ta bëjnë atë lehtësisht të aksesueshëm dhe të besueshëm nga publiku, si një sistem me integritet të fortë dhe eficient në dhënien e një drejtësie me cilësi të lartë.

Promovimi nëpër gjykata i profesionistëve më të mirë dhe me integritet të lartë, përmirësimi i administrimit të drejtësisë, monitorimi efektiv mbi performancën e gjykatave, trajtimi i drejtë i procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, si dhe forcimi i marrëdhënieve të publikut, janë tashmë nga detyrat tona imediate dhe thelbësore. Prandaj, kompetencat e dhëna na duhet t'i ushtrojmë me dinjitet e përgjegjësi, për t'i dhënë jetë rezultateve të pritshme të kësaj reforme, e cila ka përcaktuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Dhe kjo është e rëndësishme, jo vetëm për të hapur faqen e re të drejtësisë që presin qytetarët, por edhe për të kontribuar në procesin e integritetit të vendit tonë me

Bashkimin Evropian. Ndaj, gjatë marrjes së vendimeve në punë të mbajmë mend se, paanshmëria, besnikëria ndaj ligjit dhe Kushtetutës si dhe aplikimi i drejtë dhe i barabartë i ligjit nuk janë thjesht koncepte abstrakte, por janë thelbësore për suksesin e Shqipërisë në drejtim të sundimit të ligjit dhe konsolidimit të shtetit ligjor, realizimi i të cilave, ndër të tjera është edhe rruga drejt familjes tonë evropiane.

Me besimin e fortë se së bashku do t'i përmbushim më së miri këto objektiva që përcakton Kushtetuta dhe ligji "Për Këshillin e Lartë...", ju uroj të gjithëve suksese për punën dhe punë të mbarë. Si dhe falenderoj në mënyrë të veçantë partnerët tanë ndërkombëtar, EURALIUS-in, USAID-in, për mbështetjen e dhënë dhe për bashkëpunimin në vijim të punës tonë. Ju falenderoj shumë!

Sipas axhendës, do vazhdojmë me zgjedhjen e Nënkrjetarit.

(Pas përgatitjes së fletëve të votimit dhe pas votimit nga të gjithë anëtarët e Këshillit, nga administrata mblidhen fletët dhe rezultati është si më poshtë.)

Xhevdet Haxhiu: Tani po lexojmë votat për pozicionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Zonja Naureda Llagami ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Zonja Brunilda Kadi ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Më falni, më falni. Ndjesë. Për zonjën Fatmira Luli. Kërkoj ndjesë!

Zoti Ilir Toska ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Zoti Dritan Hallunaj ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Zonja Fatmira Luli ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zoti Alban Toro ka votuar për zotin Alban Toro.

Zoti Medi Bici ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Zonja Brikena Ukperaj ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Zoti Erjon Muharremaj ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zoti Maksim Qoku ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Dhe zonja Marçela Shehu ka votuar për zotin Maksim Qoku.

Atëherë, në përfundim, kandidati Maksim Qoku ka marrë: një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë (6) vota.

(Rinumërohen edhe një herë fletët e votimit.)

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë (7).

Okej, okej.

Shtatë (7) zoti Qoku. Më falni!

Zonja Fatmira Luli ka marrë tre (3) vota. Dhe zoti Alban Toro ka marrë një (1) votë.

Më falni, por emocionet bëjnë të vetën.

Naureda Llagami: Suksese kolegut!

Atëherë, sipas axhendës, do vazhdojmë mbi caktimin me short të dy anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë për të shërbyer për një mandat trevjeçar.

(Ndërkohë që përgatiten goglat për hedhjen e shortit, Këshilli zhvillon pikën e parë të rendit të ditës.)

Ndërkohë që stafi po bën gati procedurat për shortin, në cilësinë e krytares unë deklaroj vendimin për krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendim i cili daton më datë 12.12.2018.

Atëherë, “Mbi deklarimin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor – Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur për herë të parë më datë 20.12.2018, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve (5 anëtarëve jo gjyqtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 18, datë 08.02.2018 dhe 6 anëtarë gjyqtarë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve më datë 12.12.2018), mbështetur në autoritetin që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kërkesat e nenit 277, pika 3 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i angazhuar dhe besimplotë se do të sigurojë një sistem drejtësie në Republikën e Shqipërisë, bazuar mbi parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit, vendosi të deklarojë krijimin e Këshillit të Lartë të ri Gjyqësor më datë 20.12.2018”.

(Këshilli i rikthehet pikës së katërt të rendit të ditës.)

Atëherë, të procedojmë me shortin?

Rosalba Xhabrahimi: Atëherë, procedura e parë e tërheqjes së goglave nga dy gjyqtarët e gjykatës së apelit.

(Ndërkohë lexohen 2 shiritat me shkrimin “Mandat trevjeçar” dhe “Mandat pesëvjeçar”, të cilat futen në gogla për t’u tërhequr më pas nga dy anëtarët përkatës.)

Ronida Çuhadari: Mandat trevjeçar. Mandat pesëvjeçar.

Brikena Ukperaj: Mandat pesëvjeçar.

Ilir Toska: Trevjeçar.

Rosalba Xhabrahimi: Atëherë, procedura e dytë e tërheqjes së goglave nga tre gjyqtarët e shkallës së parë.

(Ndërkohë lexohen 3 shiritat me shkrimin (një shirit) “Mandat trevjeçar” dhe (dy shirita) “Mandat pesëvjeçar”, të cilat futen në gogla për t’u tërhequr më pas nga dy anëtarët përkatës.)

Ronida Çuhadari: Mandat trevjeçar, një. Mandat pesëvjeçar, e para. Mandat pesëvjeçar, e dyta.

Marçela Shehu: Mandat pesëvjeçar.

Dritan Hallunaj: Mandat pesëvjeçar.

Brunilda Kadi: Trevjeçar.

Rosalba Xhabrahimi: Procedura e tretë e përzgjedhjes së goglave nga pesë anëtarët jo gjyqtarë.

(Ndërkohë lexohen 5 shiritat me shkrimin (dy shirita) “Mandat trevjeçar” dhe (tre shirita) “Mandat pesëvjeçar”, të cilat futen në gogla për t’u tërhequr më pas nga pesë anëtarët përkatës.)

Ronida Çuhadari: Janë dy mandate trevjeçare dhe tre pesëvjeçare.

Mandat trevjeçar. Mandat trevjeçar. Mandat pesëvjeçar. Mandat pesëvjeçar. Mandat pesëvjeçar.

Maksim Qoku: Mandat trevjeçar.

Alban Toro: Mandat pesëvjeçar.

Fatmira Luli: Mandat pesëvjeçar.

Naureda Llagami: Mandat pesëvjeçar.

Erjon Muharremaj: Mandat trevjeçar.

Naureda Llagami: Atëherë, për sa i përket mandateve, përcaktimit të mandateve të anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë, mandat lidhur me shërbimin e tyre pranë Këshillit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi se, anëtarët gjyqtarë të cilët do t’i shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë: zoti Medi Bici (nga Gjykata e Lartë), zoti Ilir Toska (nga gjykata e apelit), zonja Brunilda Kadiu (*lapsus mbiemri*

Kadiu, zonja Brunilda Kadi (nga gjykata e shkallës së parë) dhe anëtarët jo gjyqtarë të cilët do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë: zoti Erjon Muharremaj dhe zoti Maksim Qoku. Faleminderit!

Mbledhja e parë e Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet e mbyllur. Ju falenderojmë!
Do mbetemi në komunikim. I uroj suksese të gjithë kolegëve!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor